

VENDIM
Nr. 478, datë 26.6.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 608, DATË 23.10.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘REHABILITIMI I HAPËSIRËS SË PALLATEVE NË KRYQËZIMIN E RRUGËS ‘KUJTIM LARO’ DHE ‘KONGRESI I MANASTIRIT’, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 608, datë 23.10.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i hapësirës së pallateve në kryqëzimin e rrugës ‘Kujtim Laro’ dhe ‘Kongresi i Manastirit’, Bashkia Tiranë”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 6 055 283.97 (gjashtë milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekësh” zëvendësohet me “... 5 510 755.44 (pesë milionë e pesëqind e dhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë pikë dyzet e katër) lekësh”;

b) Tabela, e cila përmban listën emërore të pronarëve, që preken nga shpronësimi, bashkëlidhur vendimit nr. 608, datë 23.10.2025, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me tabelën e ndryshuar, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT “REHABILITIMI I HAPËSIRËS SË PALLATEVE NË KRYQËZIMIN E RRUGËS ‘KUJTIM LARO’ DHE ‘KONGRESI I MANASTIRIT’,
BASHKIA TIRANË”

[illegible]